



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 28 të Kushtetutit të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-24-4813-1-3-6 dhe numër të brendshëm 632-24-061-136 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-9381, për shkak të mos-përbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: " ANDI E.E." SH.P.K., Prishtinë, me numër unik 811984550, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore, më dt. 13.01.2025, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM
Për ndërprerjen e Kontratës

Neni 28, paragrafi 28.1 i KPK përcakton se "Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

- i) Furnizuesi , pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 19.06.2024, me numër identifikues: 632-24-4813-1-3-6 dhe numër të brendshëm 632-24-061-136 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-9381, me titull "Furnizim me shtretër, dyshek, jastëk, çarçafë dhe tepihë për konvikt, çerdhe dhe klasat para fillore", ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Furnizuesit " ANDI E.E." SH.P.K., me seli në Prishtinë, do te ndërpritet me date 15.01.2025.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne nenin 28, paragrafi 28.1 nën: a, b, dhe c, te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Me datë 28.06.2024, ju është lëshuar urdhëresa e parë për fillimin e kryerjes së furnizimeve. Me dt. 05.07.2024, keni bërë furnizimin me shtretër dhe dyshek për konvikt(pozicioni 1 dhe 2). Me dt.07.09.2024, ju është dhënë urdhëresa e dytë për furnizim me tepihë për çerdhe dhe klasat para fillore(pozicioni 3 dhe 4), por kësaj urdhërese ju nuk i jeni përgjigjur asnjëherë edhe pse vazhdimisht kjo gjë është kërkuar nga ju.

Për mos realizimin e furnizimeve konformë kushteve të kontratës jeni të informuar disa here radhazi përmes e-maileve, sms-ve dhe telefonit të dërguara nga Menaxheri i Kontratës, ku gjithashtu jeni paralajmëruar se nëse nuk filloni kryerjen e furnizimeve do të vazhdohet me ndërprerje të kontratës dhe do të ndërmerren hapat tjerë ligjor (komunikimet i bashkëngjiten këtij njoftimi).

Përkundër vërejtjeve të shumta ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim të dinamikës për furnizimet, duke u treguar i pa përgjegjshëm për detyrimet që ju ngarkon kontrata e sipërpërmendur .

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 15.01.2025, do ti ndërmarrim të gjitha veprimet konformë kushteve te kontratës.

Shkresës i bashkëngjiten te gjitha komunikimet e deritanishme dhe dëshmitë e mos realizimit te kontratës.

Me respekt,


Udhëheqës i zyrës së Prokurimit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



DATE:	09.01.2025
PER/ZA/TO:	Zyra e Prokurimit, Faton Gutaj, znj. Venera Shtaloja
CC:	Znj. Eranda Kumnova Baçi, drejtor DKA Kryetari i Komunes - Z. Ardian Gjini
NGA/OD/FROM:	Ednor Emra-Menaxher i kontrates
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndërprerje të kontratës "Furnizimi me shtretër, dyshek, jastyk, çarçafa dhe tepiha për konvikt, qerdhe dhe klasat parafillore" me nr. kontrates 632-24-4813-1-3-6/C946

Të nderuar,

-Lidhur me Kontraten me Titull "Furnizimi me shtretër, dyshek, jastyk, çarçafa dhe tepiha për konvikt, qerdhe dhe klasat parafillore" me nr. kontrates 632-24-4813-1-3-6/C946, e lidhur në mes të Komunes së Gjakovës dhe "ANDI E.E. SH.P.K, Prishinë me numër unik 811984550, e përfaqësuar nga Faze Mahaj, ju njoftojmë se OE nuk i ka respektuar kushtet e kontratës dhe si pasojë rekomandoj ndërprerjen e kontratës bazuar në:

-Operatori ne fjalë i ka kryer punimet vetëm ne pozicionin 1 dhe 2 në kontratë, furnizim me shtretër dhe dyshek për nevojat e konviktit Sadik Stavileci-Gjakovë (me 05.07.2024 ku ka percellur edhe faturën dhe fletdergesn), ndërsa pozicionin 3 dhe 4 furnizim me tepiha për qerdhe dhe klasat parafillore për shkolla nuk i ka kryer edhe pse është njoftuar vazhdimisht me email, telefon, sms.

-Ju njoftojmë se nga ana e menaxherit të projektit janë lëshuar këto, njoftime, kërkesa dhe urdhëresa përmes emailit dhe telefonit:

- 28.06.2024 -Urdheresa e parë për fillimin e punimeve (email) dhe plani menaxhimit
- 05.07.2024- Ka kryer punimet e para (furnizim me shtretër dhe dyshek për konvikt-ka dërguar faturat dhe fletdergesn me vlerë 5400,00 euro)
- 07.09.2024-Urdheresa e dytë përmes (email)-dergohet porosia e tepihave për qerdhe dhe klasat parafillore, percellet tabela ku kërkohet të behet prezantimi i mostrave dhe matja e klasave.
- Vazhdimisht është kontaktuar në telefon dhe sms gjatë periudhës korrik-gusht 2024, por nuk i ka kryer punimet. Edhe gjatë gjithë muajit shtator është njoftuar vazhdimisht me telefon dhe sms, por punimet janë kryer.

-30.09.2024-Permes (emailit) i kam kërkuar operatorit sqarim per mos kryerjen e punimeve,por nuk kam marrë përgjigje pasi ka qene data e fundit per kryerjen e punimeve,njëkohësisht është njoftuar edhe menaxheri i drejtëperdrejtë i kontratës.

-Pas këtyre kërkesave,njoftimeve dhe Urdhëresave,Operatori Ekonomik nuk është i gatshëm për përfundimin e punimeve sipas kontratës edhe pse vazhdimisht është kontaktuar qoftë përmes emailit ose edhe telefonit (sms),i njëjti nuk i ka kryer furnizimet andaj kërkoj nga ana juaj fillimin e procedurave per ndërprerje te kontratës.

Me respekt!

EDNOR EMIRA

Bashkangjitur kërkesat,njoftimet dhe urdhëresat.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	28.06.2024
REFERENC - Ë:	Zyrtare
PER/ZA/TO:	ANDI E.E.SH.P.K., Prishtinë
CC.	Zyra e Prokurimit, z. Faton Gutaj Organi mbikëqyrës
NGA/OD/FROM:	Menaxher i Projektit –Ednor Emra-Administratë
PËRMES:	Drejtoria për Arsim – drejtor Eranda Baçi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	URDHËRESË PËR FILLIMIN E PUNIMEVE Kontrata: Furnizim me shtretër, dyshekë, jastyk, çarçafa dhe tepiha per konvikt dhe klasat parafillore

I nderuar,

Komuna e Gjakovës (qerdhet, konvikti dhe klasat parafillore) urdhëron kompaninë ANDI E.E.SH.P.K., Prishtinë për fillimin e punimeve sipas kontratës me titull "Furnizim me shtretër, dyshekë, jastyk, çarçafa dhe tepiha per konvikt, qerdhe dhe klasat parafillore", me nr. të kontratës 632-24-4813-1-3-6/C946, të nënshkruar me datë 19.06.2024

Ju mund te filloni punimet sipas kontratës më se largu më datë 01.07.2024.

Vendi i punimeve është Komuna Gjakovë (qerdhet, konvikti dhe klasat parafillore)

Me respekt,

Plani i menaxhimit dhe urdheresa per fillimin e punimeve

From ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Date Fri 6/28/2024 10:11 AM

To astrit82@outlook.com <astrit82@outlook.com>; Eranda Baçi <eranda.baci@rks-gov.net>; Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>

 2 attachments (131 KB)

C01 Plani per menaxhimin e kontratave (1) (1).Pdf; Urdherese per fillimin e punimeve-Furnizim me shtretë,dyshekë,jorgana,çarçafa dhe tepiha per konvikt,qerdhe dhe klasat parafillore 28.06.2024.docx;

Pershendetje i nderuar,

Po ju dergoj planin e menaxhimit dhe urdheresen per fillimin e punimeve,mundesisht e vulosni dhe e nenshkruani dhe ma dergoni.

Faleminderit!

Porosia e tepihave per qerdhe dhe klasat parashkollore

From ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Date Tue 7/9/2024 10:42 AM

To astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

 1 attachment (11 KB)

Porosia e tepihave per qerdhe dhe klasat parashkollore.xlsx;

Porosia e tepihave per qerdhe dhe klasat parafillore

Emri Institucionit	Tepiha	Personi kontaktues	Nr.tel
Qerdhja "Ganimete Terbeshi"-Gjakovë	310 m2	Ednor EMRA-Menaxher	044 675 201
Shkolla mesme "Nexhmedin Nixha"-Gjakovë	50 m2	Florentina Gjergjaj-Drejtore	045 400 601
Shkolla fillore "Isa Boletini"-Osek Hylë	50 m2	Mark Kegani-Drejtore	044 407 214
Shkolla fillore "Ukshin Miftari"-Skivjan	2 tepiha	Sheqfet Dinaj-Drejtore	044 269 919

Të behet prezantimi i mostrave te tepihave dhe matja e klasave

Vërejtje: Përzgjedhja e ngjyres se tepihave dhe dizajnit behet sipas kerkeses se drejtorave te shkollave.

Sqarim per moskryerje te punimeve-Furnizim me shtretër,dyshek,jastyk,çarçafa dhe tepiha per konvikt,qerdhe dhe klasat parafillore

From ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Date Mon 9/30/2024 12:31 PM

To astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

Pershendetje i nderuar,

Sot ka qene data e fundit qe te permbyllet kontrata 30.09.2024.Pozioni 3 dhe 4,furnizim me tepiha per klasat parafillore dhe qerdhet nuk jane kryer sipas datave te caktuara ne kontrate. Une disa here te kam telefonuar gjate gjithë muajit,te kam dërguar sms ne tel, te kam shkruajtur ne viber nuk je pergjigjur.Po te shkruaj me email qe ti kryhesh brenda javes punimet me tepiha,ne te kunderten do te vazhdohet sipas ligjit dhe kushteve qe jane te caktuar ne kontrate.

Do te jen te njoftuar me shkrim menaxheri i drejteperderjte i kontrates dhe zyra e Prokurimit-Gjakovë

Menaxheri i Kontrates:
Ednor Emra

(No subject)

From ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Date Wed 10/2/2024 1:17 PM

To astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

Astrit shpresoj qe je mire se pari,qoftë e kaluar,

Tu kisha lut me bo zgjidhje per tepiha,nëse smunesh vet me ardh dergo dikon tjeter të vjen ti kryen,
se ndërprehet kontrata dhe vazhdon pas me procedura gjyqësore.

Çështjen tani e ka ne duar menaxheri i drejteperdtjete dhe Zyra Prokurimit-Gjakovë.

E imja ke të njoftoj edhe njëherë!

Get [Outlook for iOS](#)

Re:

From ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Date Wed 10/2/2024 1:43 PM

To astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

Në rregull!

Get [Outlook for iOS](#)

From: astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

Sent: Wednesday, October 2, 2024 3:24:49 PM

To: ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Subject: Re:

Thirrem nesor ne telefon

From: ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Sent: Wednesday, October 2, 2024 3:17:08 PM

To: astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

Subject:

Astrit shpresoj qe je mire se pari,qoftë e kaluar,

Tu kisha lut me bo zgjidhje per tepiha,nëse smunesh vet me ardh dergo dikon tjeter të vjen ti kryn, se ndërprehet kontrata dhe vazhdon pas me procedura gjyqësore.

Çështjen tani e ka ne duar menaxheri i drejteperdtjete dhe Zyra Prokurimit-Gjakovë.

E imja ke të njoftoj edhe njëherë!

Get [Outlook for iOS](#)

(No subject)

From ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Date Tue 10/8/2024 10:52 AM

To astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

Astrit a je mire,po te thirri ne tel spo paraqitesh,

Deshta ta di nuk po me kthen pergjigje,a ke mi kry punen ku ke mbet,datat e caktuara per perfundimin e punimeve kane mbaruar.

Duhet te njoftoj DKA dhe Zyren e prokurimit per hapat me tutje.

Rekomandim per nderprerjen e kontrates

From ednor emra <nori_emra@hotmail.com>

Date Mon 11/4/2024 9:51 AM

To Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>; Venera Shtaloja <venera.shtaloja@rks-gov.net>; Eranda Baçi <eranda.baci@rks-gov.net>; Afijete Efendija <afijete.efendija@rks-gov.net>; astrit sylaj <astrit82@outlook.com>

Ju njoftoj se kontrata me numer 632-24-4813-1-3-6/C946 "Furnizim me shtretër,dyshek,jastyk,çarçafa dhe tepiha per konvikt,qerdhe dhe klasat parafillore" me operator ANDI E.E. SHPK,Prishtinë të nenshkruar me datë 19.06.2024 nuk i ka kryer punimet sipas kontrates,sipas planit te menaxhimit 3 muaj ka qene koha per kryerjen e punimeve.Operatori e ka kryer vetem pozicionin 1 dhe 2 ne kontrate,furnizimin me shtretër dhe dyshek per nevojat e konviktit Sadik Stavileci-Gjakovë.Edhe pse ka pas kohë 3 muaj per perfundimin e kontrates,operatori ne fjale nuk e ka kryer pozicionin 3 dhe 4 furnizim me tepiha per qerdhe dhe klasat parafillore per shkolla.

Operatori është njoftuar vazhdimisht me emaila,me thirrje ne telefon dhe ne viber por nuk i është pergjigjur thirrjeve.Pas perfundimit te diteve per perfundimin e kontrates eshte njoftuar edhe menaxheri i drejteperdrejtë dhe Zyra e prokurimit ne Gjakovë.

Ne attach do tju dergoj edhe emailat qe ja kom percjell operatorit ne fjale,gjithashtu jane thirrjet dhe shkresat ne viber.

Me respekt!
Menaxher i kontrates
Ednor Emra